VENDIM
Nr. 470, datë 9.7.2014

PËR NJË SHTESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2014, MIRATUAR PËR MINISTRINË E ARSIMIT DHE SPORTIT, PËR FINANCIMIN E FEDERATËS SHQIPTARE TË PESHËNGRITJES PËR PËRGATITJEN DHE PJESËMARRJEN E EKIPIT KOMBËTAR NË KAMPIONATIN BOTËROR TË PESHËNGRITJES, NË DATAT 4 - 16 NËNTOR 2014, NË KAZAKISTAN

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të nenit 10/1 të ligjit nr. 9376, datë 21.4.2005, "Për sportin", të ndryshuar, dhe të nenit 13 të ligjit nr. 183/2013, "Për buxhetin e vitit 2014", me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Financimin e Federatës Shqiptare të Peshëngritjes, në masën 14 000 000 (katërmbëdhjetë milionë) lekë, për të bërë të mundur përgatitjen dhe pjesëmarrjen në Kampionatin Botëror të Peshëngritjes, që do të zhvillohet në periudhën 4 - 16 nëntor 2014, në Kazakistan.
2. Fondet e destinuara për financimin e aktivitetit të akordohen në buxhetin e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, si transfertë e pakushtëzuar, në llogarinë ekonomike 604, programi buxhetor 08140 "Programi për sportin".
3. Efektet financiare për financimin e aktivitetit të mbulohen nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit.
4. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Federata Shqiptare e Peshëngritjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama